



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.217/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës Rjeti për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZL.Anr.217/2017 e datës 13.10.2017 e parashtruar nga organizata Rjeti për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 10.10.2017 kandidatja Valdete Idrizi për kryetare të Komunës së Mitrovicës, nga radhët e subjektit politik PDK, përmes faqes së rrjetit social Facebok nga profili i Dhurata Hoxhës ka publikuar foto me rastin e tubimit publik në Frashër të Vogël të komunës së Podujevës ku janë përfshirë edhe fëmijë nën moshën 18 vjeçare, me qëllim të zhvillimit të fushatës zgjedhore.

Me këtë rast, parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të datës 14.10.2017, thekson se ankesa është e pa bazuar pasi që nuk përbën shkelje zgjedhore, sepse fotot janë bërë në shtëpi private në një familje në fshatin Frashër i Vogël. Fotoja e publikuar në faqe të rrjetit social Facebook të Dhurata Hoxhes nuk përbën shkelje të Rregullave zgjedhore, pasi që fotoja dedigohet për vizitat private në ambiente familjare dhe nuk mund të sanksionohen si fushat zgjedhore me fëmijë.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatoj se :

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës së organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, për arsye se kandidatja Valdete Idrizi për kryetare të komunës së Mitrovicës nga radhët e subjektit politik PDK nuk ka bërë fushatë me fëmijë nën moshën 18 vjeq, ashtu si pa bazë parashtrohet në ankesë. Nga provat e bashkangjitura në ankesë nuk mund të konstatohet se ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë pasi që vizitat private në ambiente familjare nuk mund sanksionohen si fushat zgjedhore me fëmijë.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.217/2017 më datën 16.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.1 të LZP-së.